



UDHËZIM

Nr. 14, datë 29.04.2016

PËR RIORGANIZIMIN DHE PLOTËSIMIN E STRUKTURAVE ORGANIZATIVE TË PARTISË DEMOKRATIKE

Mbështetur në Nenin 38 të Statuti të Partisë Demokratike, në Vendimin e Mbledhjes së Kryesisë së Partisë Demokratike, datë 28 Prill 2016, si dhe në Rregulloren e Brendshme të funksionimit të Partisë Demokratike,

UDHËZOJ:

Riorganizimi i strukturave të Partisë Demokratike në Degë, Grupseksione dhe Seksione, me qëllim fuqizimin e strukturave në bazë dhe kompletimin e të gjithë organeve drejtuese të Degëve të Partisë Demokratike, buron nga nevoja e përshtatjes organizative të PD për të zgjeruar dhe fuqizuar veprimtarinë e Partisë Demokratike në përgatitje të zgjedhjeve të ardhshme parlamentare.

Për këtë arsye, Kryesia e Partisë Demokratike në Vendimin e saj datë 28 Prill 2016 vendosi riorganizimin e Degëve ekzistuese dhe krijimin e Degëve të reja, siç është parashikuar në këtë Vendim. Nga ana tjetër, nevoja për të zgjeruar dhe fuqizuar aktivitetin politik të strukturave bazë të PD, kërkon ndërmarrjen e hapave të mëposhtëm edhe në Degët në të cilat nuk do të mbahen zgjedhje.

I. Ngritja e Grupeve të Punës

Për zbatimin e Vendimit të Kryesisë së PD, ngrihen Grupe Pune në të gjitha nivelet organizative të Partisë Demokratike:

1- Ngritja e Grupeve të Punës pranë Qarqeve:

Në çdo Qark ngrihet Grupi Punës i Kryesisë Qendrore të PD, me përbërje sipas listës bashkëngjitur këtij Udhëzimi. Me vendim të Kryetarit të Grupit të Punës mund të shtohen anëtarë të tjerë që gjykohen të nevojshëm për realizimin me sukses të procesit.

- Grupi i Punës në bazë Qarku drejtohet nga Kryetari i Grupit të Punës së Qarkut, i cili është përgjegjësi politik për drejtimin dhe mbarëvajtjen e procesit;
- Në përbërje të Grupit të Punës përfshihen deputetë, anëtarë të Kryesisë Qendrore, Kordinatorë Kombëtarë dhe anëtarë të Këshillit Kombëtar, të zgjedhur dhe ish-drejtuës lokalë, Kryetarë dhe Sekretarë të Degëve përkatëse, Drejtues të FRPD dhe LDG në Degët ekzistuese, kandidatë që kanë përfaqësuar PD-në në zgjedhje, si dhe figura publike me reputacion dhe influencë në territorin e Degës;

2- Ngritja e Grupeve të Punës pranë Degëve të PD:

Pranë çdo Dege ekzistuese si dhe në territorin e degëve të reja që krijohen, ngrihen grupet e punës që do të realizojnë riorganizimin dhe plotësimin e strukturave të Degëve, në përputhje me këtë Udhëzim.

Për këtë qëllim, Kryetari i Grupit të Punës ngarkon personin përgjegjës në nivelin e çdo Dege, i cili mbikqyr dhe përgjigjet për të gjithë procesin e riorganizimit në territorin e Degës përkatëse. Anëtarët e Grupit të Punës së Kryesisë Qendrore të PD-së, ndahen në grupet e punës sipas Degëve respektive të Qarkut.

Anëtarë të Grupeve të Punës së Degëve, përveç Grupit të Punës të Kryesisë Qendrore, janë edhe Kryetari i Degës, Sekretari dhe Nënkryetari i Degës, të zgjedhurit vendorë në territorin përkatës si dhe drejtues të organizatave partnere FRPD dhe LDG, me banim në territor.

Në Grupet e Punës përfshihen edhe individë të tjerë, anëtarë të Partisë Demokratike, me profil të spikatur politik dhe qytetar në territor.

3- Ngritja e Grupeve të Punës në nivel Grupseksioni:

Në mbledhjen e parë të Grupit të Punës dhe Kryesisë së Degës, ngrihen Grupet e punës për çdo Grupseksion. Anëtarë të Grupit të Punës të Grupseksionit, janë anëtarë të Grupit të Punës të Kryesisë Qendrore, anëtarë të Kryesisë së Degës me banim në territorin e Degës ekzistuese (kur nuk ka krijim degësh të reja) apo në territorin e Degës së re.

Anëtarë të Grupeve të Punës pranë çdo Grupseksioni janë kryetari, sekretari, nënkryetari i Grupseksionit, si dhe kryetarët e seksioneve përbërëse të Grupseksionit.

Në këto grupe, Kryesia e Degës mund të përfshijë edhe individë të tjerë anëtarë të Partisë Demokratike, me profil të spikatur politik dhe qytetar në territor.

4- Ngritja e Grupeve të Punës pranë seksioneve të PD:

Në mbledhjen e parë të Grupseksionit, ngrihen grupet e punës pranë çdo seksioni si dhe hartohet grafiku i mbledhjeve të seksioneve përbërëse të tij.

Anëtarë të Grupit të Punës pranë çdo seksioni janë:

- Personi i ngarkuar nga Kryesia Qendrore, anëtar i Grupit të Punës së Grupseksionit;
- Dy anëtarë të Kryesisë së Degës, të ngarkuar në Grupseksion;
- Njëri prej drejtuesve të Grupseksionit (Kryetari, Sekretari ose NënKryetari);
- Kryetari dhe sekretari i Seksionit;
- Persona të tjerë, anëtarë të PD, të aktivizuar nga Kryesia e Grupseksionit.

II. Procedurat dhe Afatet

1- Mbledhjet në Seksion:

Mbledhjet në seksione zhvillohen sipas grafikut të miratuar në mbledhjen e Grupseksionit, në prani të Grupit përkatës të Punës, si më sipër. Grupseksioni, në mbledhjen e parë të tij, sipas nevojës, vendos për bashkimin e seksioneve ekzistuese apo krijimin e seksioneve të reja.

Kjo ka për qëllim të mundësojë që në çdo fshat ku numri i anëtarëve të partisë është jo më i vogël se 7 (shtatë), të ngrihet të paktën një seksion.

Në qytet, në zonat urbane, ndiqet parimi i mbulimit territorial të qendrës së votimit. Qendrat ekzistuese të votimit të ngritura me fraksione (ku lista e votuesve është e ndarë sipas rendit alfabetik), si rregull, konsolidohen në një seksion. Kryesia e Grupseksionit mund të vendosë ndryshe në raste të veçanta, me miratimin e Kryetarit të Grupit të Punës. Kur seksioni mbulon më shumë se një qendër votimi, numri i anëtarëve të seksionit duhet të jetë jo më i vogël se 15 anëtarë.

Mbledhjet e seksionit zhvillohen me praninë e mbi 50% të anëtarëve të regjistruar. Kur ka bashkim seksionesh, kuorumi merr në konsideratë anëtarësinë e përbashkët. Në seksionet që ndahen, kuorumi duhet të marrë në konsideratë anëtarësinë e territorit përkatës.

Nëse kuorumi nuk arrihet në mbledhjen e parë, Kryetari i Seksionit dhe anëtarët e grupit të punës, marrin masa për njoftimin e të gjithë anëtarëve. Më pas lihet një datë tjetër, ku procedurat vijnë pavarësisht nga plotësimi apo jo i kuorumit të mësipërm.

Rendi i ditës për mbledhjen e seksionit përmban diskutimin mbi situatën politike, përgatitjen për zgjedhjet e ardhshme, efektivitetin/fektivitetin e anëtarësisë si dhe hapat për fuqizimin e strukturave dhe zgjerimin e fuqizimin në një shkallë më të lartë të veprimtarisë së tyre.

Grupi i Punës verifikon në çdo seksion, anëtarësinë përkatëse, duke marrë masa për eliminimin e fektivitetit, zgjerimin dhe përtëritjen e anëtarësisë dhe fuqizimin e aktivizmit politik të seksionit.

Grupi i Punës evidenton në regjistrin e anëtarësisë të gjithë anëtarët jo aktivë dhe arsyet e mosaktivizimit. Për këtë, për çdo Seksion plotësohet formulari bazë, i cili përmban të dhënat kryesore për anëtarësinë (shtojca 1). Formulari origjinal i cili plotësohet sipas rubrikave dhe siglohet për çdo mbledhje të seksionit, i dorëzohet Kryetarit të Grupit të Punës.

Në seksionet ku drejtuesit e seksioneve mungojnë ose shfaqin pamundësi angazhimi, merren masa për zëvendësimin e tyre. Në seksionet që krijohen të reja apo që krijohen nga ribashkimi i seksioneve ekzistuese, zhvillohen zgjedhje të reja, sipas parashikimeve të statutit.

Në Degët ku sipas Vendimit të Kryesisë do të mbahen zgjedhje të reja, seksionet do të propozojnë, sipas statutit, kandidaturat për organet drejtuese të Degës, sipas formularit bashkëngjitur.

Mbledhjet në seksione duhet të zhvillohen brenda datës 30 maj 2016.

2- Mbledhjet në Grupseksion

Mbledhjet e para të Grupseksionit zhvillohen brenda javës së parë të fillimit të procesit, sipas këtij Udhëzimi. Në këtë mbledhje:

- Ngrihen grupet e punës si më sipër për çdo seksion;
- Vendoset për ngritjen e seksioneve të reja apo bashkimin e seksioneve ekzistuese;
- Hartohet grafiku i mbledhjeve të seksionit.

Grupseksioni sëbashku me Grupin e Punës, mbikqyr procesin në seksionet përkatëse duke u mbledhur sa herë që është e nevojshme.

Grupseksioni përcjell pranë Kryesisë së Degës kandidaturat për organet drejtuese të Degës, të propozuara nga seksionet dhe grupseksionet.

Grupi i Punës verifikon në çdo Grupseksion, anëtarësinë përkatëse, duke marrë masa për eliminimin e fektivitetit, zgjerimin dhe përtëritjen e anëtarësisë dhe fuqizimin e aktivizmit politik të seksionit.

Grupi i Punës evidenton në regjistrin e anëtarësisë të gjithë anëtarët jo aktivë dhe arsyet e mosaktivizimit. Për këtë, për çdo Grupseksion plotësohet formulari bazë, i cili përmban të dhënat kryesore për anëtarësinë (shtojca 2). Formulari origjinal i cili plotësohet sipas rubrikave dhe siglohet për çdo mbledhje të seksionit, i dorëzohet Kryetarit të Grupit të Punës.

3- Kryesia e Degës

Grupi i Punës së bashku me Kryesinë e Degës, vendos për ngritjen e Grupeve të punës dhe grafikun e mbledhjeve të çdo Grupseksioni.

Në mbledhjen e parë, Grupi i Punës dhe Kryesia e Degës vendosin edhe për:

- Ngritjen apo bashkimin e grupseksioneve, kur është e nevojshme për shkak të riorganizimit territorial të Degëve;
- Vendos për kuorimin (nr e delegatëve) për organizimin e Kuvendit Zgjedhor të Degës, aty ku do të mbahen zgjedhje të reja. Në kuptimin e nenit 21 të Statutit, anëtarët ex-officio do të jenë delegatë të Kuvendit të Degës, në territorin ku ata banojnë;
- Përcaktohen numri i delegatëve nga organizatat partnere;
- Ngarkon personat përgjegjës për përpunimin e informacionit të standardizuar, i cili do të mblidhet nga mbledhjet e seksioneve dhe grupseksioneve, sipas formularëve shoqërues të këtij Udhëzimi.

Grupi i Punës së bashku me Kryesinë e Degës, mbikqyr procesin duke u mbledhur sa herë që është e nevojshme.

Grupi i Punës së bashku me Kryesinë e Degës, pas përfundimit të zgjedhjeve nëpër seksione, miraton kandidaturat për kryetar të Grupseksionit dhe organizon zgjedhjet në çdo grupseksion.

Grupi i Punës së bashku me Kryesinë e Degës vendos për kandidaturat që do t'i përcillen për miratim Kryesisë Qendrore si dhe propozon datën e zhvillimit të Kuvendit të Degës.

Grupi i Punës së bashku me Kryesinë e Degës miraton raportin që do të mbahet në Kuvendin e Degës si dhe formulon propozimet statutore për zhvillimin e Kuvendit të Degës.

Brenda datës 30 Qershor 2016, Grupi i Punës pranë çdo Dege, përfundon procesin e riorganizimit dhe fuqizimit të strukturës, si dhe zgjedhjeve të organeve të reja të Degës në të gjitha nivelet. Në përfundim të këtij afati, Grupi i Punës raporton me shkrim pranë Kryetarit të Partisë Demokratike rezultatet e këtij procesi, duke specifikuar të dhënat sa më poshtë:

- Identifikimin e plotë të anëtarëve për çdo njësi strukturore;
- Masat e marra për riorganizimin, plotësimin dhe fuqizimin e strukturës dhe rezultatet përkatëse;
- Identifikimi i çështjeve të tjera për tu zgjidhur.

Gjatë gjithë veprimtarisë së tij, Grupi i Punës ka përgjegjësinë të sigurojë:

- Ngritjen e një sistemi raportimi efektiv për ecurinë dhe përmbushjen e detyrave të caktuara, si dhe të verifikimit në terren të çdo raportimi, dhe
- Raportimin periodik pranë Kryetarit të Partisë Demokratike për gjithë ecurinë e zbatimit të detyrave të përcaktuara.

III. Kriteret për kandidim në Organet Drejtuese të Degës:

1. Kriteret për Kryetar të Degës si dhe anëtarë të Kryesisë së Degës:

Kandidaturat për Kryetar të Degës si dhe anëtarë të Kryesisë së Degës duhet të përmbushin këto kritere:

- Të jenë anëtarë të PD;
- Të jenë me arsim të lartë;
- Të gëzojnë reputacion të lartë në komunitetin ku jetojnë;
- Të kenë një figurë të pastër morale dhe integritet shoqëror;
- Të plotësojnë kushtet e parashikuara në Ligjin Nr. 138/2015 “Për Garantimin e Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrojnë Funksione Publike”

1.1 Shmangia e konfliktit të interesit

Në rastin e zgjedhjeve të reja në Degët ekzistuese, Kryetari aktual i Degës i paraqet me shkrim Kryetarit të Grupit të Punës dorëheqjen nga funksioni i tij, në rast se ai kërkon të kandidojë përsëri për pozicionin e Kryetarit të Degës (Degës aktuale apo Degëve të reja që formohen). Pas dorëheqjes, ai mbetet anëtar i Kryesisë së Degës dhe angazhohet në plotësimin e detyrave organizative sipas këtij Udhëzimi.

2. Kriteret për Kryetar të Grupseksionit dhe Sekretar të Grupseksionit:

Kandidaturat për Kryetar të Grupseksionit dhe Sekretar të Grupseksionit duhet të përmbushin këto kritere:

- Të jenë anëtarë të PD;
- Të jenë me arsim të lartë;
- Të gëzojnë reputacion të lartë në komunitetin ku jetojnë;
- Të kenë një figurë të pastër morale dhe integritet shoqëror;

- Të plotësojnë kushtet e parashikuara në Ligjin Nr. 138/2015 “Për Garantimin e Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrojnë Funksione Publike”

Përfshirja e kandidatëve nga kriteret e caktuara në pikën 2, bëhet vetëm me vendim të Grupit të Punës.

3. Kriteret për Kryetar të Seksionit dhe Sekretar të seksionit:

Kandidaturat për Kryetar të Seksionit dhe Sekretar të Seksionit duhet të përmbushin këto kritere:

- Të jenë anëtarë të PD;
- Mundësisht të jenë më arsim të lartë;
- Të gëzojnë reputacion të lartë në komunitet ku jetojnë;
- Të kenë një figurë të pastër morale dhe integritet shoqëror
- Të plotësojnë kushtet e parashikuara në Ligjin Nr. 138/2015 “Për Garantimin e Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrojnë Funksione Publike”

IV. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI



LULZIM BASHA

Sekretar i Përgjithshëm

Arben Ristani

